

## KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 82/18), me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, nr. 18-105/1 të datës 28. II. 2023, në bazë të Konkursit të shpallur më 07. II. 2023 në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ si dhe në web faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe u zgjodh unanimitisht Komisioni recensues në këtë përbërje:

- 1. Prof. dr. Agim VINCA** (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës „Hasan Prishtina“,
- 2. Prof. dr. Ejup AJDINI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. dr. Emine SHABANI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Duke falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues dorëzon këtë

### REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN HISTORIA E LETËRSISË SHQIPE (LETËRSIA BASHKËKOHORE SHQIPTARE (PROZA) 1 DHE LETËRSIA BASHKËKOHORE SHQIPTARE (POEZIA) 2) DHE TEORIA E LETËRSISË (TEORIA E LETËRSISË 1 DHE 2), (61208, 61207 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në konkursin e shpallur në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ të datës 07. II. 2023, si dhe në ueb-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, është paraqitur vetëm kandidati **Dr. Vjollca Berisha**.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe të të dhënave të tjera të kandidatit, Komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

## **Të dhëna biografike dhe arsimimi:**

Vjollca Berisha ka lindur më 15 gusht 1983 në Prishtinë. Prej vitit 1994 jeton dhe vepron në Tetovë. Shkollimin fillor të filluar në Prishtinë, e kreu në Shkollën Filllore „Liria“ në Tetovë, në vitin 1998. Shkollimin e mesëm në Gjimnazin „Kiril Pejçinoviç“ në Tetovë, drejtimi: përgjithshëm, me sukses të shkëlqyeshëm nga viti 1998 deri 2002. Në vitin akademik 2002/2003 është regjistruar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës, programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Në vitin 2006 diplomoi dhe fitoi titullin *profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe* me notë mesatare 9,2.

Ajo ka qenë studente e dalluar e gjeneratës së saj dhe për këtë në vitin 2006 e ka pranuar ceremonialisht diplomën e saj nga rektori i atëhershëm i Universitetit të Tetovës, ceremoni kjo që u dedikojë vetëm studentëve elitarë. Gjatë studimeve ka qenë mjaft aktive në botimin e recensioneve, studimeve, eseve dhe krijimeve letrare në revista letrare të studentëve e të qarqeve të ndryshme letrare. Ajo ka qenë pjesëmarrëse dhe udhëheqëse e një sërë aktiviteteve letrare në kuadër të Universitetit të Tetovës dhe jashtë tij. Ka qenë udhëheqëse e grupit letrar dhe atij të mbledhësve të folklorit që funksiononte në kuadër të katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Në vitin akademik 2008/2009 është regjistruar në studimet pasuniversitare në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, drejtimi Letërsi Shqipe. Pas dhënies së provimeve të parapara, më 5. XI. 2010, mbrojti me sukses temën e magjistraturës me titull: „*Shekulli im i Kadaresë – gjeneza e frymëzimit dhe modeli i ligjërimit*“ në mentorimin e Prof. dr. Agim VINCËS dhe fitoi titullin *Magjistër i letërsisë shqipe*, me notë mesatare 10.

Në vitin akademik 2012/2013, Mr. Vjollca Berisha është regjistruar në studimet e doktoraturës në Fakultetin e Filologjisë dhe Historisë në Universitetin e Tiranës, drejtimi Letërsi Shqipe. Disertacioni i doktoraturës që nga fusha e historisë së letërsisë dhe përfshinte një pjesë të madhe të historisë së letërsisë sonë kombëtare, siç është letërsia e Maqedonisë, përkatësisht poezia, zhvillimi i saj, përsosja e mjeteve të shprehjes, lidhjet dhe dallimet me poezinë bashkëkohore shqipe në shkallë kombi etj. Më 11. XII. 2021 e mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës me temë: „*Tipologjia e poezisë shqipe në Maqedoni*“ u vlerësua me vlerësimin „Shumë mirë“ (vlerësim maksimal) para një jurie akademikësh e pedagogësh të nderuar si: 1. Prof. dr. Ymer ÇIRAKU (mentor), 2. Prof. dr. Persida ASLLANI (kryetar), 3. Akad. Floresha DADO (anëtar), 4. Prof. dr. Dhurata SHEHRI (anëtar), 5. Prof. dr. Arben PRENDI (anëtar) dhe fitoi gradën shkencore *Doktor në studime letrare*.

## 1. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Në vitin akademik 2006/2007, Vjollca Berisha zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *asistent i ri* në fushën e Gjuhës shqipe. Nga viti akademik 2006/2007 deri në vitin akademik 2022/2023 veprimtarinë mësimore-arsimore e realizoi duke mbajtur ligjërata dhe ushtrime në lëndët *Letërsia bashkëkohore shqipe (proza) 1 dhe 2*, *Letërsia bashkëkohore shqipe (poezia) 2*, *Romantizmi në letërsinë shqipe 1 dhe 2*, *Lexim dhe interpretim 1 dhe 2*, *Teori e letërsisë 1 dhe 2*, *Shkrim kreativ*, *Analizë gjuhësore e tekstit*, *Analizë letrare e tekstit*, *Teori e romanit*, *Semiotikë* programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, si dhe *Gjuhë shqipe I dhe II* në programet studimore Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Gjuhë dhe Letërsi Frënge, Gjuhë dhe Letërsi Italiane, Gazetari, Sociologji, Filozofi, Psikologji dhe Pedagogji.

Përveç ligjëratave dhe ushtrime, kandidatja Vjollca Berisha, realizon dhe konsultime me studentët e Fakultetit Filologjik, programi studimor: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të lëndëve përkatëse në studimet deridiplomike.

Nga punësimi i saj në Universitetin e Tetovës (viti akademik 2006/07) deri më sot, Dr. Vjollca Berisha u angazhua në një sërë aktiviteteve letrare si mentore e studentëve që përgatisnin revista letrare, mbrëmje poetike, përurime librash, panele e diskutime letrare. Ajo njihet si një nga pedagogët më të përkushtuar që krijon atmosferë letrare në mesin e studentëve, duke i inkurajuar për shkrime e botime, në mesin e të cilëve është realizuar edhe ndonjë libër individual nën mbikëqyrjen, redaktimin e recensimin e profesoreshës Vjollca Berisha.

Dr. Vjollca Berisha vazhdimisht ka kryer dhe vazhdon të kryejë detyra të rëndësishme të katedrës, të fakultetit dhe të universitetit në të cilin është e punësuar, si: anëtare e Këshillit redaktues të revistës së Fakultetit Filologjik „Cogito”, anëtare e Këshillit redaktues të revistës shkencore „Filologjia” dhe „Albanologjia“. Vjollca Berisha ka qenë pjesëmarrëse në projektin hulumtues shkencor „Eposi i kreshnikëve – monument i trashëgimisë kulturore shqiptare në Ballkan: Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi (Malësi e Madhe), Maqedoni (zona Kumanovë-Kërçovë, Serbi (Lugina e Preshevës), të realizuar në kuadër të hulumtimit mbi shkallën e ruajtjes së Eposit të kreshnikëve në Ballkan, Analizës krahasuese të eposit midis kulturave të Ballkanit, Tiparet estetike të këngëve në të gjitha rastet e ruajtura, si këngë e përcjellë me instrument, si tekst poezie pa melodi, apo vetëm si rrëfim gojor me tipare të narracionit prozaik, i cili u realizua më 15.01.2015 nga ana e Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidatja **dr. Vjollca Berisha** ka realizuar gjithsej **178.62 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

## 2. Veprimtaria kërkimore-shkencore:

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja Dr. Vjollca Berisha është marrë vazhdimisht me realizimin e veprimtarisë hulumtuese shkencore në fushën e shkencave filologjike, gjegjësisht në lëmin e letërsisë. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore. Krahas pjesëmarrjes së madhe në konferenca mbarëkombëtare e ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, si dhe krahas punimeve kërkimore-shkencore të botuara në revista të ndryshme shkencore, komisioni ka veçuar vetëm ato që janë botuar dhe një pjesë që janë në proces të botimit, por që kandidatja i ka prezantuar në konferenca e simpoziume shkencore nga viti 2006 e deri në vitin 2023. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur si më poshtë:

### 2.1. Punime shkencore të lexuara/ të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare

1. **Vjollca Berisha:** „Tëhuajësimi atipik nga motivi i atdheut”, *Albanologjia - International Journal of Albanology*, 15-16/2021, f. 176-181, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 821.18(497.7).09 (print form), Tetovë, 2018.
2. **Vjollca Berisha:** „10 vështirësi të përfshirjes së letërsisë shqipe në botimet enciklopedike“, *Studime - Revista për studime filologjike*, nr. 20, f. 427-431, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014.
3. **Vjollca Berisha:** „Etos dhe poetikë, Dominimi i qases deskriptive në studimin lindja, martesë, mortja në Malësinë e Tetovës të Fadil Sulejmanit“, *Filologjia - International Journal of Human Sciences*, 1-2/2014, f. 85-89, ISSN: 1857-8535, UDC: 81'25 (print form).
4. **Vjollca Berisha:** „Novatorizmi poetik kadarean dhe receptimi i tij”, revista “Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare nga pavarësia deri më sot” (në këtë revistë janë botuar përmbledhje aktesh të konferencës së shtatë shkencore kushtuar 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012.
5. **Vjollca Berisha:** „Gjurmët e një qyteti”, përmbledhje punimesh të prezantuara në Seminarin IV Ndërkombëtar të Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2010.
6. **Vjollca Berisha:** „Metanarracioni – karakteristikë e romanit postmodern“ *Revista „Cogito”*, nr. 4-5/2009, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2009.
7. **Vjollca Berisha:** „Qasje krahasuese mbi librat Shtëpia e bukurosheve të fjetura të jasunari Kavabatës dhe *Kujtim kurvas të trishta* nga Gabriel Garcia Marquez: Pleqëri pranë një vajzukeje“ *Revista „Cogito”*, nr. 4-5/2009, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2009.

## **2.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:**

1. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XVI Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Kultura dhe globalizimi“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28-29 shtator 2022**.
2. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XV Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Shqiptarët dhe kultura e kujtesës“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **22 nëntor 2021**.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Java e Albanologjisë me temë: „Ngjizja e një letërsie të shkëputur“, organizuar nga Instituti Albanologjik, **22 qershor 2021**.
4. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XIII Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Gjuha, letërsia dhe identiteti“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25-26 shtator 2019**.
5. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Konferencën e organizuar nga Universiteti „Aleksandër Moisiu“ – Durrës me temë: „Zhvillimi i letërsisë shqipe në vitet 1945-1990. Figura në poezinë e sotme shqipe“, Durrës, **10 qershor 2019**.
6. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XII Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28 shtator 2018**.
7. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e XI Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Kujtesa, kultura dhe mediat e reja“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28-29 shtator 2017**.
8. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e X Ndërkombëtar të Albanologjisë me temë: „Letërsia shqipe në shekullin XX“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **29-30 shtator 2016**.
9. **Certifikatë** për pjesëmarrje në tryezën shkencore „Leksiku i ri poetik në poezinë e sotme shqipe“ organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 15 qershor 2015.
10. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Parë Shkencore të Fakultetit Filologjik me temë: „Veprimtaria shkencore dhe arsimore e Fadil Sulejmanit“, Universiteti Shtetëror i Tetovës, **14 shkurt 2014**.
11. **Certifikatë** për pjesëmarrje në tryezën shkencore „Letërsia në tekstet enciklopedike“ organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 7 qershor 2013.
12. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Seminarin e VI Ndërkombëtar të Albanologjisë, organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, **20-23 shtator 2012**.

## **2.3. Parathënie recensuese librash dhe recensione të lexuara në akte përurimesh të veprave letrare**

1. Recension dhe parathënie në librin „Krahnezë“ të Valdeta Dulahit, Tetovë, Syth, 2021.
2. Recension dhe parathënie në librin poetik „Për gjysmën tjetër të hënës“ të Nuriye Emurllait, Tetovë, 2019.
3. Recension dhe parathënie në librin „Dashuri në kohën e feisbukut“ të Arlind Farizit, Tetovë, 2019.
4. Recension dhe parathënie mbi librin „Kujtesa e ujërave që rrjedhin“ të Ibrahim Veliut, Tetovë, 2018.
5. Recension mbi librin „Palestina në tri pamje“ të Agim Vincës, Prishtinë, 2021.

6. Recension mbi librin për fëmijë „Xhela rritet një herë tjetër” të Agim Devës, Tetovë, 2019.
7. Recension mbi librin „Dritë dhe mjegull” të Agim Vincës, Tetovë, 2018.
8. Recension mbi librin „Reflekse mitike” të Luljeta Isakut, Tetovë, 2018.
9. Parathënie në librin „Duke luajtur symbyllazi”, antologji e poezisë bashkëkohore shqipe, Tetovë, 2020.
10. Parathënie në librin „Ninullat e kulmit”, Tetovë, 2020.
11. Recension mbi librin „Zana e fundit e bjeshkëve”, tregime të zgjedhura për fëmijë nga autorë bashkëkohorë shqiptarë, Syth, Tetovë, 2019.
12. Recension dhe parathënie në librin „Pikëbardha” të Sefer Selimit, Shkup, 2019.
13. Recension dhe parathënie në librin „Një prerje e shoqërisë” të Nazim Rashidit, Tetovë, 2022.
14. Recension dhe parathënie në librin „Këngë kapuçash” të Abdullah Zendelit dhe Xhabir Ahmetit, Shkup, 2020.
15. Recension mbi librin „Trashëgimia etnokulturore e Rekës së Epërme” të Zejna Halimit, Syth, Tetovë, 2022.
16. Recension mbi librin „Nga mështeknaja e babait me mallëngjim”, e Lindita Ahmetit Panalbanica.net, 2019.
17. Recension mbi librin „Psalme murgu” e Agim Vincës, Mitrovicë, 2012.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidatja **Dr. Vjollca Berisha** ka realizuar gjithsej **66 pikë** nga **veprimtaria kërkimore-shkencore**.

### **3. Veprimtaria profesionale-aplikative:**

#### **3.1. Libra nga fusha profesionale**

1. „Matanë s’ka harrim”, Syth, Tetovë, 2021, **ISBN - 978-608-4927-13-6**
2. „Ninullat e kulmit”, përzgjedhje, Syth, Tetovë, 2020, **ISBN - 978-608-4927-06-8**
3. „Duke luajtur symbyllazi” (antologji e poezisë shqipe të dashurisë), Syth, Tetovë, 2020, **ISBN - 978-608-4927-05-1**
4. „Ma fal një lepur”, Syth, Tetovë, 2020, **ISBN - 978-608-4927-12-9**
5. „Një baba e gjysmë”, Syth, Tetovë, 2019, **ISBN - 978-608-66267-7-8**
6. „*Shekulli im* i Kadaresë (gjeneza e frymëzimit dhe model i ligjërimit), Albas, Tetovë, 2018, **ISBN - 978-608-237-048-4**

### 3.2. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidatja **Dr. Vjollca Berisha** ka realizuar gjithsej **56 pikë** nga **veprimtaria profesionale-aplikative**.

## 4. Veprimtari me interes më të gjerë:

### 4.1. Anëtar i këshillit redaktues të revistës shkencore / profesionale ndërkombëtare

1. Filologjia - *International Journal of Human Sciences*, University of Tetova, ISSN: 1857-8535 (Print), ISSN: 2671-3012 (online).
2. Albanologjia - *International Journal of Albanology*, University of Tetova, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (online).
3. Revista shkencore *Juvenilia*.
4. Revista shkencore *Fjalë e valë*.
5. Revista letrare *Syth*.

### 4.2. Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional

1. Konferenca e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha, letërsia dhe kultura – arritjet dhe perspektivat“, Universiteti i Tetovës, **16-18 nëntor 2022**.
2. Seminari XVI Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Kultura dhe globalizimi“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28-29 shtator 2022**.
3. Seminari XV Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Shqiptarët dhe kultura e kujtesës“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **22 nëntor 2021**.
4. Seminari XIV Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Sfidat e (mos)zbatimit të ligjit të gjuhëve në Maqedoninë e Veriut dhe gabimet gjatë përdorimit të shqipes standarde“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25 nëntor 2020**.
5. Konferenca e Gjashtë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha, letërsia dhe kultura në shekullin XXI“, Universiteti i Tetovës, **13-15 nëntor 2019**.
6. Seminari XIII Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Gjuha, letërsia dhe identiteti“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **25-26 shtator 2019**.
7. Konferenca e Pestë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Prurje të reja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën“, Universiteti i Tetovës, **7 dhjetor 2018**.

8. Seminari XII Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **28 shtator 2018**.
9. Seminari XI Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Kujtesa, kultura dhe mediat e reja“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **29-30 shtator 2017**.
10. Konferenca e Katërt Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Gjuha dhe letërsia - Sfidë specifike në zhvillimin socio-etik dhe atë profesional“, Universiteti i Tetovës, **21-22 prill 2017**.
11. Seminari X Ndërkombëtar i Albanologjisë me temë: „Letërsia shqipe në shekullin e XX“, organizuar nga Universiteti i Tetovës, **30 shtator-1 tetor 2016**.
12. Konferenca e Tretë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Bashkëpunimi brendakulturor shqiptar“, Universiteti Shtetëror i Tetovës, **22-23 prill 2016**.
13. Konferenca e Dytë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Filologjik me temë: „Ndërveprimet kulturore ndërmjet filologjisë shqiptare dhe shkencave filologjike në rajon dhe më gjerë - dimensionet diakronike dhe sinkronike“, Universiteti Shtetëror i Tetovës, **24-25 prill 2015**.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, kandidatja **dr. Vjollca Berisha** ka realizuar gjithsej **18 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

## 5. Formulari për raportin për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore

Në shtojcat e mëposhtme është bashkëngjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja **dr. Vjollca Berisha** ka siguruar gjithsej **318.62** pikë, përkatësisht në: veprimtarinë mësimore-arsimore **178.62** pikë, veprimtarinë kërkimore-shkencore **66** pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative **56** pikë dhe në veprimtarinë me interes më të gjerë **18** pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN		Pikët
I.	VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	178.62
II.	VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	66
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	56
IV.	VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	18
<b>Gjithsej</b>		<b>318.62</b>



## 6. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidatja **dr. Vjollca Berisha** në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01.12.2021**, ka grumbulluar **318.62 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar disafish numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidatja **dr. Vjollca Berisha** ta zgjedhë në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** në lëmin Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, 11. V. 2023

### Komisioni recensues:

**1. Prof. dr. Agim VINCA** (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës „Hasan Prishtina“

---

**2. Prof. dr. Ejup AJDINI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

---

**3. Prof. dr. Emine SHABANI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

---

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Vjollca Muharrem Berisha**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR - DOCENT

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve  Suksesi mesatar në ciklin e parë: <b>9,2</b> . Suksesi mesatar në ciklin e dytë: <b>10,00</b> . Suksesi mesatar <b>9,6</b> për studimet e integruara	<b>Po</b>
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: <b>Shkencat humane (6)</b> , fusha <b>Shkenca mbi letërsinë (612)</b> , sfera <b>Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207)</b>	<b>Po</b>
3	Të publikuara së paku 4 (katër) punime shkencore të recensuara <sup>1</sup> në publikime shkencor referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	<b>Po</b>
3.1	Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emeral, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë	<b>Po</b>

<sup>1</sup> Për kandidatin/ët që ka publikuar më tepër se 4 (katër) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues do t'i theksojë, vlerësojë me pikë dhe vendos në Formularin 2.

	<p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Albanologjia - International Journal of Albanology</b></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: <b>Ebsco</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„Tëhuajësimi atipik nga motivi i atdheut“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919, 2018</b></p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Filologjia - International Journal of Human Sciences</b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <b>45 - numri i përgjithshëm, 10 vende: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Kosova, Gjeorgjia, Gjermania, Rumania, Turqia.</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„Etos dhe poetikë, Dominimi i qases deskriptive në studimin lindja, martesë, mortja në Malësinë e Tetovës të Fadil Sulejmanit“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>ISSN: 1857-8535 (Print), 2014</b></p>	
3.2	<p>Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe nuri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b>Studime - Revista për studime filologjike</b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <b>25 - numri i përgjithshëm, 3 vende: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut.</b></p> <p>3. Titulli i punimit: <b>„10 vështirësi të përfshirjes së letërsisë shqipe në botimet enciklopedike“</b></p> <p>4. Data e publikimit: <b>2014</b></p>	Po
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur</p> <p>1. Gjuha e huaj: <b>Angleze</b></p> <p>2. Emri i dokumentit: <b>Certifikatë B2</b></p> <p>3. Dhënësi i dokumentit: <b>„Teach“ Tirana</b></p> <p>4. Data e dhënies së dokumentit: <b>05.06.2007</b></p>	Po
5	<p><b>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>Universiteti i Tetovës</b></p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>Mësimdhënie</b></p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë <b>2006-2022</b></p>	Po

## FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE  
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Vjollca Muharrem Berisha**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Historia e letërsisë shqipe (Letërsia bashkëkohore shqiptare (proza) 1 dhe Letërsia bashkëkohore shqiptare (poezia) 2) dhe Teoria e letërsisë (Teoria e letërsisë 1 dhe 2), (61208, 61207 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### I. VEPRIMTARIA MËSIMORË-ARSIMORË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Se m.	Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i parë i studimeve)					<b>108</b>
<b>1.1</b>	<b>Letërsia bashkëkohore shqipe (proza) 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	4	15	2	<b>4.8</b>
<b>1.2</b>	<b>Letërsia bashkëkohore shqipe (poezia) 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	4	15	2	<b>4.8</b>
<b>1.3</b>	<b>Teori e letërsisë 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	2	<b>2.4</b>
<b>1.4</b>	<b>Teori e letërsisë 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	2	<b>2.4</b>
<b>1.5</b>	<b>Lexim dhe interpretim 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.6</b>	<b>Lexim dhe interpretim 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.7</b>	<b>Analizë gjuhësore e tekstit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	3	<b>3.6</b>
<b>1.8</b>	<b>Analizë letrare e tekstit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	3	<b>3.6</b>
<b>1.9</b>	<b>Shkrim kreativ</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.10</b>	<b>Teori e romanit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.11</b>	<b>Semiotikë</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.12</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gjuhë dhe Letërsi Angleze)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.13</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gjuhë dhe Letërsi Angleze)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.14</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gjuhë dhe Letërsi Frënge & Gjuhë dhe Letërsi Italiane)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.15</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gjuhë dhe Letërsi Frënge & Gjuhë dhe Letërsi Italiane)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.16</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gazetari)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.17</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gazetari)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.18</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Sociologji & Filozofi)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.19</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Sociologji & Filozofi)	0.04	2	15	6	<b>7.2</b>
<b>1.20</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Psikologji & Pedagogji)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>
<b>1.21</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Psikologji & Pedagogji)	0.04	2	15	4	<b>4.8</b>

<b>2</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b> (cikli i parë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Se m.	<b>67.5</b>
<b>2.1</b>	<b>Letërsi bashkëkohore shqipe (proza) 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	4	15	6	<b>10.8</b>
<b>2.2</b>	<b>Letërsi bashkëkohore shqipe (poezia) 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	4	15	6	<b>10.8</b>
<b>2.3</b>	<b>Romantizmi në letërsinë shqipe 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	2	15	6	<b>5.4</b>
<b>2.4</b>	<b>Romantizmi në letërsinë shqipe 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	2	15	6	<b>5.4</b>
<b>2.5</b>	<b>Lexim dhe interpretim 1</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.6</b>	<b>Lexim dhe interpretim 2</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.7</b>	<b>Analizë gjuhësore e tekstit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	3	<b>1.35</b>
<b>2.8</b>	<b>Analizë letrare e tekstit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	3	<b>1.35</b>
<b>2.9</b>	<b>Shkrim kreativ</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.10</b>	<b>Teori e romanit</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.11</b>	<b>Semiotikë</b> (Gjuhë dhe Letërsi Shqipe)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.12</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gjuhë dhe Letërsi Angleze)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.13</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gjuhë dhe Letërsi Angleze)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.14</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gjuhë dhe Letërsi Frënge & Gjuhë dhe Letërsi Italiane)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.15</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gjuhë dhe Letërsi Frënge & Gjuhë dhe Letërsi Italiane)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.16</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Gazetari)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.17</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Gazetari)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.18</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Sociologji & Filozofi)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.19</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Sociologji & Filozofi)	0.03	1	15	6	<b>2.7</b>
<b>2.20</b>	<b>Gjuhë shqipe I</b> (Psikologji & Pedagogji)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>2.21</b>	<b>Gjuhë shqipe II</b> (Psikologji & Pedagogji)	0.03	1	15	4	<b>1.8</b>
<b>3</b>	<b>Konsultime me studentët</b>					<b>1.92</b>
<b>3.1</b>	Konsultimet me studentë	60x16x0.002				<b>1.92</b>
<b>4</b>	<b>Anëtar i komisioneve</b>					<b>1.2</b>
<b>4.1</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të diplomës, cikli I	12 x 0.1				1.2
<b>Gjithsej (1+2+3+4)</b>						<b>178.62</b>

## II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	<b>12</b>
<b>1.1</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Tipologjia e poezisë shqipe në Maqedoni“, Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë i Universitetit të Tiranës, tezë e doktoraturës	<b>8</b>
<b>1.2</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „ <i>Shekulli im</i> i Kadaresë – gjeneza e frymëzimit dhe modeli i ligjërimit“, Fakulteti Filologjik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, tezë e magjistraturës	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale</b>	<b>30</b>
<b>2.1</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Tëhuajësimi atipik nga motivi i atdheut“, <i>Albanologjia - International Journal of Albanology</i> , 15-16/2021, f. 176-181, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), UDC: 821.18(497.7).09 (print form), Tetovë, 2018.	<b>5</b>
<b>2.2</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „10 vështirësi të përfshirjes së letërsisë shqipe në botimet enciklopedike“, Studime - Revista për studime filologjike, nr. 20, f. 427-431, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014.	<b>4</b>
<b>2.3</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Etos dhe poetikë, Dominimi i qases deskriptive në studimin lindja, martesë, mortja në Malësinë e Tetovës të Fadil Sulejmanit“, <i>Filologjia - International Journal of Human Sciences</i> , 1-2/2014, f. 85-89, ISSN: 1857-8535, UDC: 81'25 (print form).	<b>5</b>
<b>2.4</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Novatorizmi poetik kadarean dhe receptimi i tij“, revista „Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare nga pavarësia deri më sot“ (në këtë revistë janë botuar përmbledhje aktesh të konferencës së shtatë shkencore kushtuar 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012.	<b>4</b>
<b>2.5</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Gjurmët e një qyteti“, përmbledhje punimesh të prezantuara në Seminarin IV Ndërkombëtar të Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2010.	<b>4</b>
<b>2.6</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „Metanarracioni – karakteristikë e romanit postmodern“ Revista „Cogito“, nr. 4-5/ 2009, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2009.	<b>4</b>
<b>2.7</b>	<b>Vjollca Berisha:</b> „ <i>Qasje krahasuese mbi librat</i> Shtëpia e bukurosheve të fjetura të jasunari Kavabatës dhe <i>Kujtim kurvas të trishta</i> nga Gabriel Garcia Marquez: Pleqëri pranë një vajzukeje“ Revista „Cogito“, nr. 4-5/2009, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2009.	<b>4</b>
